

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRIË**

Për Aktivitetin e Prokurimit nr: **VU644-23-14245-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GOE: N.N.P. Hysnia; POUK Group Sh.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Vërrnicë - Vushtrri
(Adresa)

Vushtrri, Kosovë,
(Vendi)

42000
(Kodi postar)

+383- 044/176184
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Hysni Shabani
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj dhe i Autorizuar)

np_hysnia@hotmail.com
(Adresa elektronike)

27.02.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues – **Komuna e Vushtrrisë**, me date 27.12.2023 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve** si në vijim:

- ☐ Procedurë e hapur,
- ☐ Kontrate publike,
- ☐ Shërbim, Vlerë e madhe
- ☐ Vlera e parashikuar e kontratës: **180,543.80 euro**
- ☐ Kriteri për dhënie të kontratës: **Çmimi me ulet i tenderit të përgjegjshëm!**

Njoftimi për kontratë: 27.12.2023

Hapja e ofertave: 05.02.2024

Njoftimi mbi vendimin e AK - B058-2023: 11.02.2025

Kërkesa për rishqyrtim kundër vendimit të AK 17.02.2025

Vendimi i AK për refuzim të Kërkesës për rishqyrtim 18.02.2025.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Hapja e tenderit është bërë në mënyrë elektronike në vendin e caktuar dhe në kohën e caktuar.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Te pa kënaqur me rezultatin përfundimtar, lidhur me njoftimin për eliminimin e ofertës tonë nga aktiviteti i prokurimit, ne kundërshtim të plotë me LPP-ne dhe dokumentet standarde të Legjislacionit sekondar të KRPP-se, brenda afatit ligjorë, kemi paraqitur kërkesë për ri-shqyrtim në pajtim me kërkesat e nenit 108/A, të LPP-se, kundër vendimit të AK për rezultatin e aktivitetit në fjalë.

(Bashkëlidhur me këtë ankese gjeni edhe kërkesën për ri-shqyrtim të dorëzuar në AK).

Me datë 18.02.2025, kemi pranuar refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim si te pa bazuar (bashkëlidhur e gjeni vendimin e AK)

Dhe, te pa kënaqur me vendimin e AK për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim si të pa bazuar, parashtrojmë ankese në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik në pajtim me nenin 109 të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me Vendimin e Autoriteti kontraktues **Komuna e Vushtrrisë** dhe në pajtim me nenin 109 të LPP-së parashtrojmë ANKESË kundër;

- **Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të datës 18.02.2025;**
- **Njoftimit të Vendimit të AK për rezultatin e tenderit të datës 11.02.2025**

Pretendojmë se **Komuna e Vushtrrisë**, përmes Zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka bërë shkelje të dispozitave të;

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejshëm do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Neni 1 të LPP-së
- Neni 6 të LPP-së
- Neni 7 të LPP-së
- Neni 59 të LPP-së
- Neni 65 paragrafi 4 pika 4.12 të LPP-së
- Neni 69 të LPP-së
- Neni 71 të LPP-së
- Neni 72 të LPP-së
- Neni 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
- Neni 116, par 6.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne vijim do ti trajtojmë pretendimet tona ne ANKESË duke e kundërshtuar :

▪ **Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 18.02.2025;**

Zyrtari përgjegjës i Autoriteti Kontraktues, ne kundërshtim me dispozitat e nenit 108/A, paragrafit 8, nen paragrafit 8.4 dhe paragrafit 12 të LPP-se, refuzon kërkesën pa i shqyrtuar të gjitha pretendimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim.

ZPP e ka obligim ligjor që secilin pretendim të ngritur nga pala ankuese, të trajtoj në përputhje me dispozitat e nenit 8.4, ngase duhet të shqyrtoj secilin pretendim ashtu siç është kërkuar nga ankuesi, kurse AK me këtë vendim ka bërë shkelje substanciale të dispozitave të Legjislacionit primar dhe atij sekondar të LPP-se.

Pretendimi i parë: AK pa drejtësisht dhe ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe Legjislacionit sekondar, refuzon kërkesën për rishqyrtim me ane të vendimit Nr.100/25, dt.18.02.2025, me vetëm një arsyetim të përgjithshëm, pa trajtuar fare pretendimet ankimore te ankuesit.

Arsyetimi i AK, në kërkesën për rishqyrtim është si ne vijim , shih arsyetimin e AK:

A.K. konstaton se Refuzohet Kërkesa për Ri-shqyrtim e OE-Ankues pasi që AK-Komuna e Vushtrrisë ka pranuar dhe zbatuar VENDIMIN e OSHP: 2024/1290 të datë 07.02.2025, e i cili Vendim ka karakter detyrues për AK, në këtë rast AK thekson se kemi të bëjmë me rasë të gjykuar dhe Vendim përfundimtar andaj AK-ZPP konsideron se nuk ka nevoj të jap përgjigje sipas pretendimeve Ankimore por vetëm njofton dhe konstaton të cekurat.

Pra, arsyetimi i AK në këtë rast është arbitrar dhe për me tepër në interpretim tërësisht te gabuar të dispozitave të LPP-se, Legjislacionit Sekondar të KRPP-se dhe Vendimit të OSHP-se, nr.2024/1290 të datës 07.02.2025,sepse:

- Ne rastet kur, aktiviteti i prokurimit kthehet në Ri-Vlerësim, siç është vendosë ne rastin konkret nga organi i OSHP-se, atëherë AK, duhet zbatuar këtë vendim të OSHP-se dhe aktiviteti kthehet në piken zero (0), ku te gjithë OE pjesëmarrës në këtë aktivitetet duhet ekzaminuar, vlerësuar dhe krahasuar ofertat, madje referuar paragrafit 6 të nenit 116, citojmë: *Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.* Pra, referuar dispozitës ligjore te lartë cekuar, sipas vendimit të OSHP-se, obligim detyrues për AK është të kthej aktivitetin në Ri-Vlerësim dhe ri-vlerësimi të bëhet në përputhje me kërkesat e nenit 59 të LPP-se dhe OSHP-ja nuk e detyron AK të shpërblej me kontratë OE të caktuar, siç arsyetohet AK.
- Referuar letrës standarde për tenderuesin e eliminuar dhe arsyetimit të AK, konsiderojmë se kemi të bëjmë aplikim të gabuar të përdorimit të dokumentit standard të KRRP-se, për faktin se konsorciumi ynë është i përgjegjshëm dhe nuk mund të aplikohet dokumenti i letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, për me tepër kjo e vërtetuar edhe vet nga AK, ku fillimisht shpërblehemi me kontratë (**shih vendimin fillestar të AK**) për shkak se kemi qene

të përgjegjshëm dhe me çmimin me të ulët, ndërsa tani në këtë fazë, AK konsorciumin tonë e konsideron palë pa interes juridik dhe çështje të gjykuar e që në rastin konkret kemi të bëjmë me gjykim subjektiv pa bazë Ligjore, se vendimi i A.K për t'i rekomanduar për dhënie të kontratës GOE: ECO CLEAN & Energy; Dardaniaa Sh.P.K.; Ibrahim Kurrumeli B.I., është marrë për herë të parë.

- AK, bënë abuzim me vendimin e OSHP-se, kur arsyetohet se KK Vushttri, ka pranuar dhe **zbatuar** vendimin e OSHP-se, ku sipas AK - ZPP, konsideron se nuk ka nevojë të jap përgjigjeje për pretendimet ankimore të Ankuesit. Pra, në këtë rast kemi të bëjmë me abuzim të vendimit të OSHP-se nga ana e AK, sepse vendimi i OSHP-se, kërkon që aktiviteti të kthehet në Ri-Vlerësim dhe jo të mos jap përgjigjeje në pretendimet ankimore të ankuesit, siç konstaton ZPP-ja i AK.

Prandaj, bazuar në sqarimet e lartë cekura, vendimi i AK për refuzim të kërkesës për Ri-shqyrtim është i pa qëndrueshëm, pa mbështetje ligjore, në interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-se, në aplikim të gabuar të legjislacionit sekondar të KRPP-se dhe abuzim me Vendimit e OSHP-se dhe rrjedhimisht Vendimi është i pa pranueshëm dhe si tillë duhet të anulohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik të Kosovës.

- **Ndërsa sa i përket rezultatit të tenderit në lidhje me njoftimin e Vendimit të AK për rezultatin e tenderit të datës 11.02.2025**, qëndrojmë në tersi prapa kërkesës për rishqyrtim sepse pas qasjes në dokumente të OE të propozuar për kontratë kemi vërtetuar se GOE nuk është i përgjegjshëm.

Pretendimi i dytë, është po i njëjti edhe në kërkesën për rishqyrtim:

Ku pretendojmë se GOE të Propozuar për kontratë nuk ka përmbushur kriteret e përzgjedhjes të pikës 2 të kërkesës 9.1 & 9.2, të (FTD), me që rast rezulton që vlerësimi i rriskut, të GOE përkatësisht udhëheqësi i grupit nuk ka dorëzuar fare dokumentin e vlerësimit të rriskut, nga një kompani e licencuar nga organi kompetent (MPMS). E që dokumenti i ngarkuar mbi vlerësimin e rriskut i dorëzuar nga GOE është lëshuar në emër të antarit të grupit, "Dardaniaa Sh.P.K.", ku edhe ky dokument është jo-valid dhe rrjedhimisht i kundërligjshëm dhe si i tillë do duhej të trajtohej si nga komisioni i vlerësimit ashtu edhe nga zyrtari përgjegjës i prokurimit të A.K.

Gjithashtu kërkojmë edhe nga eksperti por edhe nga paneli i OSHP-së, që pas administrimit të dokumentit në fjalë, të trajtojnë si të vlefshëm, respektivisht të pa ligjshëm për faktin se dokumenti i tillë, vlerësimi i rriskut i dorëzuar nga Dardaniaa sh.p.k., është në kundërshtim me Ligjin 04/L161 për Sigurinë dhe shëndetin në punë, konkretisht RREGULLORE (MPMS) Nr. 02/2021 PËR VLERËSIMIN E RISKUT NË VENDIN E PUNËS, kreu VI, neni 15 pika 1 e rregullores, e cili thotë, Citat: "*Rishikimi i vlerësimit të rriskut në vendin e punës duhet të bëhet jo më pak se një herë në 2 vite*" mbarim i citatit.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore, rezulton padiskutueshëm se vlerësimi i rriskut i dorëzuar nga G.O.E. është dokument jo-valid, pasi që, së pari dokumenti në fjalë është lëshuar me datën 20.07.2020 që e bënë dokumentin të pavlefshëm sepse nuk është në pajtueshmëri me ligjin dhe rregulloret që përcaktojnë afatin e vlefshmërisë të dokumentit në fjalë dhe së dyti për shkak se një

dokument i tillë nuk është i dorëzuar nga Udhëheqësi i GOE, konkretisht nga O.E. ECO CLEAN & Energy.

Pretendimi i tretë, është po i njëjti edhe në kërkesën për rishqyrtim:

Gjithashtu Tenderi i **GOE: ECO CLEAN & Energy; Dardaniaa Sh.P.K.; Ibrahim Kurrumeli B.I.** është i papërgjegjshëm dhe si i tillë duhet refuzuar pranueshmëria e tij për arsye se **O.E. ECO CLEAN & Energy** si lider i grupit, nuk disponon asnjë referencë apo kontratë se në 3 vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme si në titull të këtij aktiviteti të prokurimit (*për vërtetësinë e deklaratës së lartcekur shih dokumentin 4 specifikisht 7.2 me emërtim “Kontrata dhe Referenca”, e cila gjendet ne dosjen e GOE*).

Kështu duke mos e arritur as përafërsisht, vlerën e kontratave të realizuara në shumë prej **216 000.00 euro**, respektivisht **60%** të vlerës së kërkuar, ashtu sikur është përcaktuar dhe kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, Pjesa FTD (Fleta e dosjes së tenderit) Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 9.1 & 9.2, kërkesa nr. 1.

Në bazë të dokumentit siç emërtohet “**Deklaratë**” (*Aneks I*), e bashkangjitur në “Marrëveshje për themelimin e grupit të operatorëve ekonomik (konsorciumit)”, **O.E. ECO CLEAN & Energy** autorizohet si partner kryesor (lider), i cili gjithashtu nga eksperti shqyrtues dhe paneli I OSHP-së me vendimin e tij (Nr. **OSHP: 2024/1290**, të datës **07/02/2025**) cilësohet si lider. Marrë parasysh se **O.E. ECO CLEAN & Energy**, i përcaktuar si lider nuk përmbush as minimalen e kërkesave të (FTD) Neni 9.1 & 9.2, kërkesa nr. 1 dhe si i tillë tenderi i **GOE: ECO CLEAN & Energy; Dardaniaa Sh.P.K.; Ibrahim Kurrumeli B.I.** duhet refuzuar sepse nuk e plotësojnë kërkesat e përzgjedhjes të NJK dhe DT.

Pretendimi i katërt, është po i njëjti edhe në kërkesën për rishqyrtim:

Bazuar në dëshmitë e dokumentacionit të dosjes së tenderit të **GOE: ECO CLEAN & Energy; Dardaniaa Sh.P.K.; Ibrahim Kurrumeli B.I.**, të marrë nga qasja për dokumente të realizuar në zyrën e Prokurimit të **A.K.**, me datë (**14.02.2025**) kemi vlerësuar se ekziston dyshim i bazuar se dokumentacioni i prezantuar në emër të personit që drejtpërdrejtë është përgjegjës, për realizimin e projektit të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore, në rastin konkret të **z. Avdi Rashica**, ing. i Ndëtimtarisë, është dokumentacion jo i rregullt. Meqenëse ekziston dyshim i bazuar se i njëjti nuk është në marrëveshje bashkëpunimi me **GOE**, dhe se dokumentacioni i prezentuar nga Grupi në emër të **z. A. Rashica** është keqpërdorur. Po ashtu ekziston dyshim i bazuar se **z. A. Rashica**, asnjëherë nuk ka qenë staf i **GOE** për faktin se nuk është person i deklaruar në **ATK** nga **O.E. ECO CLEAN & Energy**. Si rrjedhojë e mungesës së dokumentit të letërnjoftimit të **Z. Rashica** ne nuk kemi pasur mundësi ta verifikojmë gjendjen, andaj kërkojmë me ngulm nga **A.K.** që në procesin e rivlerësimit të tenderëve, ashtu siç ka rekomanduar edhe paneli shqyrtues në vendimin **nr. OSHP: 2024/1290**, të datës **07/02/2025**, saktësisht në piken **2**, me ç ‘rast aktivitetin e prokurimit; “*Mirëmbajta dimërore e rrugëve*” me nr të prokurimit: **VU644-23-14245-2-1-1**, ta kthej në rivlersim, të kërkoj një deklaratë me shkrim nga **z. Rashica** lidhur me statusin e tij në këtë kompani, me pyetjen është apo jo në marrëveshje bashkëpunimi me **O.E. ECO CLEAN & Energy**, për shkak se pretendojmë se përgjegjësi kryesor **z. Avdi Rashica** nuk ka qene dhe nuk është pjese e stafit të **GOE** të propozuar për kontratë dhe rrjedhimisht pretendojmë se **GOE** të lartë cekur nuk është i përgjegjshëm.

Pretendimi i pestë, është po i njëjti edhe në kërkesën për rishqyrtim:

Gjithashtu bazuar në vlerësimin nga ana jonë të dokumentacionit të dosjes së tenderit të GOE. në fjalë, të marrë nga qasja për dokumente të realizuar në zyrën e Prokurimit të A.K., kemi vlerësuar se ekziston dyshim i bazuar se dokumentacioni i prezentuar lidhur me përmbushjen e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale, të saktësuara në FTD neni 9.1 & 9.2. Kërkesa nr. 5, saktësisht Fatura nr. 01/24 e datës 03.01.2024 me të cilën është tentuar të dëshmohet se O.E. ka në posedim mjete pune: “2 freza dore për Largimin e borës në Trotuare” është dokument jo-valid, dhe sipas vlerësimit tone, është dokument i paplotësuar sepse si i tillë nuk përmbanë informacione në përshkrimin e mjeteve (Freza dore) në faturë, nuk përmban asnjë informacion rreth markës, tipit, nr. serik, kapacitetit etj. Gjithashtu dokumentit në fjalë nuk i është bashkangjitur as foto dhe as dokument i mjeteve me të cilin dëshmohet pronësia në emër të shitësit për rastin konkret, andaj mbi bazën e këtyre të dhënave kërkojmë nga komisioni i rivlerësimit dhe ZPP i A.K. që të ketë parasysh këto fakte me rastin e rivlerësimit të tenderit dhe në përfundim të rivlerësimit të nxjerr vendim meritore me të cilin do ta refuzoj tenderin e GOE: ECO CLEAN & Energy; Dardaniaa Sh.P.K.; Ibrahim Kurrumeli B.I, sepse, pretendojmë se GOE të lartë cekur nuk është i përgjegjshëm.

Për më tepër, kriteret e përzgjedhjes janë qenësorë për një vlerësim të drejtë dhe meritore, për faktin se janë kusht administrativ, ku DT përbën dokumentin qenësor të aktivitetit të prokurimit dhe për hire të sigurisë juridike, me paragrafin 3 të nenit 7 të LPP-se, **çdo AK i ndalohe shprehimisht çdo shmangieje nga termat dhe kriteret e precizuara në DT**, sepse sipas paragrafit 1, të nenit 27 kanë karakter material, kurse devijimi eventuale atakon parimin e barazisë sikurse sanksionohet me nenin 7 të LPP-së.

Sjellim në vëmendje se barazia para ligjit është një prej të drejtave themelore të garantuar me nenin 3 dhe 24 të Kushtetutës. Më tutje, në bazë të Nenit 21, paragrafit 4 të Kushtetutës, këtë të drejtë kushtetuese e gëzojnë edhe personat juridik, duke përfshirë edhe kompanitë.

Barazia para ligjit, sipas interpretimeve gjyqësore, kërkon që personat (fizik dhe juridik) të kenë trajtim të njëjlojtë, kur janë në rrethana të njëjta – siç janë operatorët ekonomik në rastin konkret. Sidoqoftë, në asnjërin nga këto momente nuk u veprua konform legjislacionit në fuqi, kështu, GOE “ECO CLEAN & Energy; Dardaniaa Sh.P.K.; Ibrahim Kurrumeli B.I”, mbeti në garë edhe në procedurën e rivlerësimit, përveç se kësaj here tejet më i favorizuar se herën e parë.

Ku, me këtë vendim, AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 1, par 1 dhe 3; nenin 6, par 1 të LPP-se, sepse shpërblen me kontratë GOE “ECO CLEAN & Energy; Dardaniaa Sh.P.K.; Ibrahim Kurrumeli B.I”, të pa përgjegjshëm me çmimin e ofruar **169,096.00€** apo dy fish më lartë se sa Konsorciumi ynë i cili ka ofruar çmimin **89,592.00€**, e që në këtë rast, Autoriteti kontraktues me këtë veprim dëmton buxhetin varfër e Republikës së Kosovës dhe të KOMUNËS në veçanti, i cili buxhet përbehet nga taksat e qytetareve të Republikës së Kosovës dhe, demi që do të shkaktohet është në shumë prej **79,504.00€** dhe vlenë të ceket se në vitet e kaluara, saktësisht 2022-2023-2024, po i njëjti projekt 2 vjeçarë i publikuar nga A.K. është realizuar nga kompania jonë për vlerën e ofertuar prej 70,418.00€ dhe A.K. janë ndarë plotësisht të kënaqur nga angazhimi dhe intervenimi në terren. Këtë mund ta vërtetoni edhe ju tek referencat që kemi bashkangjitur në dosjen ofertuese me nr të kontratës: VU644-21-6039-2-2-1/C441, 14 Nr. 04/22 e datës 10.01.2022. Për më tepër ne

ketë rast çdo vendim i cili e favorizon GOE "ECO CLEAN & Energy; Dardaniaa Sh.P.K.; Ibrahim Kurrumeli B.I", është i dëmshëm dhe përbën vepër penale ne sa i përket dëmtimit të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, kërkojmë nga **OSHP-ja**, të nxjerr:

VENDIM

- ✓ Të nxjerrë vendim meritore me të cilin të aprovoj ANKESEN të bazuar të paraqitur nga **GOE "GOE: N.N.P. Hysnia; POUK Group Sh.P.K."** ;
- ✓ Te anulohet vendimi i AK – **Komuna e Vushtrrisë**, për refuzim të kërkesës për Ri-shqyrtim;
- ✓ Të anulohet njoftimi për tenderuesin e eliminuar dhe Vendimin B58 për dhënie të kontratës për GOE "ECO CLEAN & Energy; Dardaniaa Sh.P.K.; Ibrahim Kurrumeli B.I", sepse është i pa përgjegjshëm si GOE dhe
- ✓ Te kthehet rastin në Ri-Vlerësim dhe vlerësimi të bëhet me kërkesat dhe kriteret e përzgjedhjes dhe të vlerësimit sipas NJK dhe DT.

Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt,

Hysni Shabani

9. Dëmet materiale

Përkrahja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Sigurimi i Tenderit, Dokumentet për përgatitjen e tenderit për konkurrim
Ankesat, Dëmit ekonomik dhe financiar i fitimit të planifikuar shumë se projektit 10% dhe Humbja e imazhit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.